



## JANARI 2022 VJEN ME MË SHUMË MUNDËSI PËR FËMIJËT DHE TË RINJËT

1

### FILLOJNË ZBATIMIN 16 PROJEKTET FITUESE TË THIRRJES SË PARË TË AGJENCISË KOMBËTARE TË RINISË

Për herë të parë në vitin 2021, Qeveria Shqiptare mbështet financiarisht projekt-propozimet nga organizata rinore/për të rinjtë dhe bashki të vendit. Plot **12 projekte** fituese nga organizata rinore dhe për të rinjtë do të zbatohen përgjatë vitit 2022 në **20 Bashki** të **11 Qarqeve** të ndryshme të vendit, ku rreth **1500 të rinj** shqiptarë do të angazhohen dhe përfitojnë drejtpërdrejtë nga programet e vullnetarizmit dhe punës rinore, debatit, aktivitetet artistike, kulturore, sportive dhe rekreative, në trajnimet dhe mentorimet për zhvillimin e projekteve të sipërmarrjes në fushat e TIK-ut, arteve, zejeve, dhe bujqësisë dhe rreth **6500 të rinj të tjerë** do të ndikohen përmes fushatave në terren dhe informimit në media sociale dhe platformave online të dedikuara.

Po ashtu **4 projektet fituese nga Bashkitë** kanë filluar punën për ngritjen apo përmirësimin e infrastrukturës në sporte, kulturë dhe teknologji, të cilat janë Qendra Rinore në Bashkinë Elbasan, biblioteka publike në Bashkinë Roskovec, Qendra Rinore në Bashkinë Lezhë dhe Qendra Rinore në Petrelë, që do të sigurojnë mjedise të përshtatshme për aktivizimin e të rinjve dhe gjallërimin e këtyre zonave.



2

### 196 TË RINJ PUNËSOHEN PAS PËRFUNDIMIT TË PROGRAMIT KOMBËTAR TË PRAKTIKËS SË PUNËS

Në 25 Janar 2022 u finalizuan kontratat e punësimit për **196 praktikantë**, pjesë e Thirrjes VI të Programit Kombëtar të Praktikës së Punës.

Këta të rinj nga mosha **21 deri në 26 vjeç**, që kanë përfunduar praktikën e punës dhe janë përzgjedhur, tashmë kanë filluar punën në **12 aparate** dhe **43 institucione** varësie dhe degë rajonale.

3



### QENDRA MULTIFUNKSIONALE MICRO-FOLIE

Në janar 2022 u hap **muzeu i parë digjital** i Micro-Folie, në lulishten mbrapa Kryeministrit. Kjo hapësirë e pakëzuar nga ne si "Çmenduri të vogla" do të jetë thelbi i programit tonë afatgjatë "**Art, Zeje, Sport, Teknologji**" për mësimin pas shkolle. Në Micro-folie mund të vizitohet muzeu digjital, laboratoritë teknologjike të prodhimit, biblioteka, këndi i lojrave, si dhe një skenë për performanca artistike. Muzeu është i hapur nga e marta në të premte për vizita nga shkollat, ndërkohë fundjavat janë të hapura për gjithë familjen. Në javët në vijim çdo fundjavë do të ketë **aktivitete kulturore dhe teknologjike për gjithë familjen**. Për ju prindër që keni dëshirë të zbuloni talentet e fëmijëve tuaj, mund të rezervoni në: [microfolietirana@gmail.com](mailto:microfolietirana@gmail.com)

4

### KRIJIMI I EKIPEVE SPORTIVE

Sporti është një nga prioritetet për të rinjtë e fëmijët, prandaj edhe kemi filluar punën për krijimin e ekipeve sportive në arsimin parauniversitar. Për të rritur bashkëpunimin në këtë program kombëtar, kërkuam mbështetjen e Kryetarëve të Bashkive, Drejtorëve të Zyrave Vendore Arsimore, si dhe gjithë federatave të sportit.

Së shpejti në shkollat 9-vjeçare, në shkollat e mesme dhe në Universitete, fëmijët dhe të rinjtë do kenë mundësi të përfshihen në **ekipe sportive pa pagesë** për të zhvilluar talentet e tyre në **sportet e volejbollit dhe basketbollit** dhe të jenë pjesë në kampionate në nivel qarku e kombëtare.

Çdo prind i interesuar për fëmijët, i ri apo e re, që ka dëshirë të jetë pjesë e një ekipe sportive mund të kontaktojë mësuesit e edukimit fizik për t'u regjistruar në sportin e preferuar.



5

### VIJON KONSULTIMI PËR STRATEGJINË E RINISË

Procesi i konsultimit paraprak për Strategjinë Kombëtare të Rinisë vijon edhe pas përmbylljes me sukses të konsultimit me **1100 të rinj** nga **68 gjimnaze e universitete** të **22 bashkive të Shqipërisë**. Tashmë po realizohen takimet e konsultimit me organizatat rinore, për të rinjtë dhe shoqatat e grupet joformale, si dhe me Këshillin Kombëtar Rinor. Pjesëmarrës në konsultime kanë qënë **41 organizata** që veprojnë në rrethe të ndryshme të Shqipërisë.